



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 21 tetor 2024  
Nr. ref.:RK 2564/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI39/24**

Parashtrues

**Xhylinaze Rama**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së**  
**Aktgjykimit [Pml. nr. 187/2023] të 23 majit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës**

### **GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Xhylinaze Rama nga Vitia (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 187/2023] e 23 majit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 733/22] e 3 marsit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 222/2021] e 24 nëntorit 2022 të Gjykatës Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Parashtruesja e kërkesës aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 11 korrik 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesja e kërkesës nuk ka qartësuar saktësisht se cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë i janë cenuar përmes aktit të kontestuar.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 16 shkurt 2024, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 21 shkurt 2024, Kryetarja e Gjykatës, përmes Vendimit [nr. GJR. KI39/24], caktoi gjyqtaren Remzie Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe përmes Vendimit [nr. KSH. KI39/24], caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 19 mars 2024, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
10. Më 19 mars 2024, Gjykata gjithashtu njoftoi Gjykatën Themelore në Gjilan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që t' ia dorëzojë Gjykatës fletëkthesën përmes së cilës dëshmohet se kur parashtruesja e kërkesës e kishte pranuar aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
11. Më 22 mars 2024, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë, ku përfshihet Aktgjykimi [P. nr. 1189/2022] i 4 prillit 2023 i Gjykatës Themelore në Gjilan, përmes të cilit asaj i ishte shqiptuar vërejtje gjyqësore.
12. Më 27 mars 2024, Gjykata Themelore ia dorëzoi Gjykatës fletëkthesën që tregon se parashtruesja e kërkesës aktin e kontestuar e kishte pranuar më 11 korrik 2023.

13. Më 29 maj 2024, parashtruesja e kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë së bashku me disa mesazhe të rrjeteve sociale, dhe kërkoi nga Gjykata që të merret me urgjencë me rastin e saj.
14. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

15. Bazuar në shkresat e lëndës, rezultoi që i biri i parashtrueses së kërkesës A.R është privuar nga jeta nga B.R. pas një konflikti fizik në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit A.R dhe B.B. Parashtruesja e kërkesës si palë e dëmtuar kishte dëshmuar në rast në cilësinë e dëshmitares, duke treguar se si ka ardhur deri tek konflikti në mes të djalit të saj te ndjerë A.R. dhe të akuzuarit B.R. Si palë e dëmtuar dhe në cilësinë e dëshmitarit kishte dëshmuar edhe bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës I.R njëherit babai i të viktimës A.R.
16. Më 24 dhjetor 2021, Prokuroria Themelore në Gjiilan – Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria) ngriti aktakuzën [PP. I. nr. 128/2021] ndaj të akuzuarit B. R. nga Vitia, për shkak të veprave penale, vrasje e rëndë nga neni 173, paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK) dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, sepse *“me datën 13.07.2021, ne ora 10:59 minuta, ne Viti, rruga "Kemal Azizi", me dashje ka privuar nga jeta tani te ndjerin A.R, dhe ka tentuar ta privoj nga jeta te dëmtuarin B.B, në atë mënyrë qe pas një konflikti fizik, ne mes tani të akuzuarit dhe dy te dëmtuarve, përball Restorant-Picerisë "D&D", ne Viti, të njëjtit takohen përsëri mbi urën e lumit "Morava", përball shkollës "Hoxhe Junuzi", ne Viti, me ç rast ndalen të dëmtuarit, e me pas nga vetura e llojit "OPEL", ngjyre e bardhe me targa te Zvicrës, del i dëmtuari A, me shkop dore ne dore, nisjet ne drejtim te veturës "BMW X5", me tabele te regjistrimit BE-856-674, ngjyre e bardhe, e ndaluar pas veturës se tij, ne atë moment, nga kjo veture del i akuzuari me revole ne dore e prodhimit "Tisas Zig14", me numër serik To620-19BLo3 846, cal. 9mm, me të vërejtur te akuzuarin me revole, i dëmtuari A. ik dhe hynë në veturën e tij, e që i akuzuari afrohet te vetura, tek xhami i derës se shoferit, ku ishte i ulur tani i ndjeri A., dhe shtënë ne drejtim te tij duke e goditur me katër plumba, ne pjesën anësore të epërme te krahut te majtë, pastaj nisjet ne drejtim te dëmtuarit B.B, i cili ishte ulur ne ulësen e përparme te pasagjerit dhe shtënë një herë në drejtim te tij, e me pas afrohet tek dera e pasagjerit ku ishte duke dalur i dëmtuari B.B, dhe shtënë përsëri me revole pese herë në drejtim të tij, duke e goditur në abdomen, në shpatullën e djathte, kofshën e majte, dhe te djathte, e deri sa ishte duke u larguar, i akuzuari e godet edhe me shkelma ne pjese te ndryshme te trupit, pasi qe i dëmtuari A. goditet me arme nga i akuzuari, ne atë gjendje e nis veturën, i cili për pasojë e godet veturën e llojit "BMW", ngjyre e zeze, me ç rast lëndimet trupore pësojnë B.I dhe H.I, e nga inercioni automjeti i llojit "BMW", e godet automjetin e llojit "Golf IV", me targa 06-379-BR, të dëmtuarit M.A, te cilit i shkakton dëme materiale, ne këtë mënyrë nga veprimet e të akuzuarit i ndjeri A. ndërron jetë duke u transportuar rrugës për ne Spitalin Regjional te Gjiilanit, ndërsa te dëmtuarit B i shkakton lëndime të natyrës së rëndë trupore”.*
17. Më 24 nëntor 2022, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 222/2021], shpalli fajtor të akuzuarin B.R. për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 të KPRK-së dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe i shqiptoi dënimin me burgim me kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) viteve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 13 korrikut 2021 e tutje. Palët e dëmtuara B.B, I.R, XH.R dhe B.I për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

18. Në një datë të pasaktësuar, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, paraqiti ankesë përfaqësuesja e autorizuar e palës së dëmtuar për shkak të vendimit për dënim, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit t'i shqiptohet dënim më i ashpër se sa që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. Gjithashtu edhe mbrojtësit e të dënuarit B.R. paraqiten ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënim, me propozimin që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim apo të ndryshohet përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.
19. Më 3 mars 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKR. nr. 733/22], aprovoi pjesërisht ankesën e mbrojtësve të dënuarit dhe sipas detyrës zyrtare ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale dhe vendimin për dënimin, ashtu që veprën penale vrasja e rëndë nga neni 173, par.1 nënparagrafi 1.5 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor, e cilëson si veprën penale vrasje e rëndë nga neni 173, par.1 nënparagrafi 11 të KPRK-së, dhe ia shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 24 (njëzetekatër) vite, duke marrë si të vërtetuar dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje 2 (dy) vite, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, par.1 KPRK-së, dhe e gjykoj me dënim unik në kohëzgjatje prej 25 (njëzetepesë) vite, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 13 korrikut 2021 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit.
20. Në një datë të pasaktësuar, mbrojtësit e të dënuarit B.R. kishin parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen si dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje apo të ndryshohen përkitazi me cilësimin juridik dhe vendimin për dënimin, ashtu që të dënuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë.
21. Më 23 maj 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 187/2023], aprovoi pjesërisht kërkesën e përbashkët të mbrojtësve të dënuarit, duke ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe atë të Gjykatës së Apelit, sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe vendimit për dënimin, ashtu që Gjykata Supreme gjen se në veprimet e të dënuarit, të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit nën pikën 1, pasqyrohen elementet e veprës penale vrasja nga neni 172 të KPRK-së dhe për këtë e gjykon me 19 (nëntëmbëdhjetë) vite burgim, ndërsa duke ia marrë si të vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite të shqiptuar për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366, par. 1 KPRK-së, konform dispozitës së nenit 76, par.2 nën paragrafit 2.2 të KPRK-së, i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) vite në të cilin dënim llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga 13 korriku 2021 e tutje.

### **Pretendimet e parashtrueses së kërkesës**

22. Parashtruesja e kërkesës, si pretendim kryesor para Gjykatës, ka ngritur çështjen e vlerësimit të dënimit të dënuarit nga Gjykata Supreme, duke pretenduar se e njëjta në mënyrë jo të drejtë e ka ulur dënimin nga 30 vite burgim në 20 vite.
23. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka bërë shkelje ligjore, pasi që siç thekson ajo *"... kur është mbajtur seanca në Gjykatën Supreme ka qenë gjendja më e rënduar emocionale shpirtërore, në atë gjykatë vetëm pse më kanë rrjedhur lotët njëri prej gjykatësve ka urdhëruar sigurimin me më largu prej gjykatës mos me marrë pjesë në seancë ... jam shumë e lënduar prej Gjykatës Supreme"*.

24. Më tej, parashtruesja e kërkesës pretendon se nuk ka mundur të parashtrojë kërkesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme, pasi që sipas saj, *“arsyeja ime që nuk kam paraqitë ankesë për këtë vendim të Gjykatës Supreme është se kam qenë e vetme pa përkrahjen e askujt, kam qenë në gjendje të rënduar emocionale, shpirtërore, jam trajtuar në Viti te Dr.F.P neurolog ... ende jam me terapi deri në qershor masnej kam vizitë prapë. Kjo është arsyeja pse nuk jam ankuar gjatë afatit kohor”*.

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa e parashtrueses së kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.

27. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 47 (Kërkesa individuale), nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”*.

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”*.

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*.

28. Gjykata më tej i referohet edhe rregullit 29 (Llogaritja e periudhës kohore) dhe rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës:

Rregulli 29

(Llogaritja e periudhës kohore)

*Periudha kohore, e përcaktuar në Kushtetutë, në Ligj dhe në këtë Rregullore, llogaritet si më poshtë:*

[...]

*(d) Kur periudha shprehet me muaj, ajo përfundon me kalimin e ditës së njëjtë kalendarike të muajit me ditën gjatë të cilës ka ndodhur ngjarja ose veprimi për të cilin duhet të llogaritet periudha kohore.*

[...]

*(g) përjashtimisht, nëse periudha përfundon të shtunën, të dielën ose në ndonjë festë zyrtare, ajo do të vazhdojë deri në fund të ditës së parë të punës që vjen pas saj.*

Rregulli 34  
(Kriteret e pranueshmërisë)

*“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

[...]

*(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit; dhe*

29. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 187/2023] e 23 majit 2023 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
30. Megjithatë, bazuar në nenin 49 (Afatet) të Ligjit, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse kërkesa e tanishme është dorëzuar brenda afatit ligjor katër (4) mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se rregulli i afatit katër mujor është autonom dhe duhet kuptuar dhe aplikuar bazuar në faktet e secilit rast veç e veç për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për të paraqitur kërkesën para Gjykatës. Gjykata thekson se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajve, të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës, i shërben sigurisë juridike dhe siguron që çështjet që ngrenë çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe parandalon autoritetet dhe personat e tjerë të afektuar që të mos mbahen në një gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI61/23](#), me parashtrues, *Hedie Bylykbashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 majit 2023, paragrafi 33; [KI24/23](#), me parashtrues, *Sami Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 prillit 2023, paragrafi 21; dhe rastin e GjEDNj-së, *Lekić kundër Sllovenisë*, kërkesat nr. 10865/09, 45886/07 dhe 32431/08 Aktgjykim i 11 dhjetorit 2018, paragrafi 64). Ky rregull gjithashtu i jep kohë parashtruesit potencial nëse do të paraqes një kërkesë në Gjykatë, dhe, nëse po, të vendosë për argumentet specifike që do t'i paraqes si dhe rrjedhën e fakteve, pasi që me kalimin e kohës bëhet i vështirë shqyrtimi i çështjeve të ngritura nga parashtruesi i kërkesës (shih, rastin e Gjykatës [KI115/20](#), me parashtrues *Muharrem Rama*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 nëntorit 2021, paragrafët 55 dhe 56; dhe rastin e GjEDNj-së, *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafët 52 dhe 55).



32. Gjykata po ashtu, me këtë rast rikujton dhe i referohet përmbajtjes së nenit 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit i cili përcakton:

Neni 50  
(Kthimi në gjendjen e mëparshme)

*Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj.*

33. Bazuar në përmbajtjen e nenit 50 të Ligjit, pasi që të bëhet kërkesa konkrete për kthim në gjendje të mëparshme duhet të plotësohen edhe kushtet në vijim: (i) parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se pa fajin e tij/saj nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, përkatësisht afatit 4 (katër) mujor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit; (ii) parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës; (iii) parashtruesi i kërkesës duhet të arsyetojë kërkesën e tij; dhe (iv) nuk ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë Ligj për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë. Këto kushte janë kumulative (shih, rastin e Gjykatës, K1163/20, parashtrues "Inter Eminex", Aktvendim për Papranueshmëri, i 18 shkurtit 2021, paragrafi 48). Thënë këtë, afati katër (4) mujor fillon të rrjedhë nga dita e pranimit të vendimit të fundit në kuadër të procesit të shterimit të mjeteve juridike (shih, rastin e Gjykatës [KI59/18](#), me parashtrues *Strahinja Spasić*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 marsit 2019, paragrafi 51; dhe rastin e GjEDNj-së, [Chapman kundër Belgjikës](#), kërkesa nr. 39619/06, Vendim i 5 marsit 2013, paragrafi 34).
34. Në rastin konkret, Gjykata thekson që parashtruesja e kërkesës nuk ka bërë kërkesë konkrete për të kërkuar kthim në gjendje të mëparshme (shih rastin KI217/21 Parashtrues Enver Zhjeqi, Kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme lidhur me kërkesën KIO2/20, të cilën Gjykata Kushtetuese, përmes Vendimit të 29 prillit 2020, e refuzoi me procedurë të shkurtër dhe Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 245/2019, të 17 shtatorit 2019, Aktvendim për papranueshmëri i 6 tetorit 2022). Gjykata vëren që në shkresë të lëndës parashtruesja ka bashkëngjitur disa udhëzime të lëshuara nga mjekët, e të cilat mbajnë datat 29 shtator 2023 përkatësisht 13 nëntor 2023 dhe 25 janar 2024, ndërsa kërkesën e saj pranë Gjykatës e dorëzoi më 16 shkurt 2024.
35. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 187/2023] e 23 majit 2023 të Gjykatës Supreme, por duke mos specifikuar se cilat të drejta dhe liri kushtetuese pretendon se i janë shkelur. Nga fletëkthesa e dorëzuar në Gjykatë nga Gjykata Themelore, vërtetohet që parashtruesja e kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme e ka pranuar më 11 korrik 2023, dhe se kërkesën e saj në Gjykatë e ka dorëzuar më 16 shkurt 2024, më shumë se 7 muaj pas pranimit të aktit të kontestuar.
36. Thënë këtë, afati katër (4) mujor fillon të rrjedhë nga dita e pranimit të vendimit të fundit në kuadër të procesit të shterimit të mjeteve juridike (shih, rastin e Gjykatës [KI59/18](#), me parashtrues *Strahinja Spasić*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 marsit 2019, paragrafi 51; dhe rastin e GjEDNj-së, [Chapman kundër Belgjikës](#), kërkesa nr. 39619/06, Vendim i 5 marsit 2013, paragrafi 34).

37. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se kur parashtruesit i njihet e drejta për të pranuar kopjen e vendimit përfundimtar të gjykatave të rregullta, bazuar në objektin dhe qëllimin e nenit 49 (Afati) të Ligjit, afati prej 4 (katër) muajsh fillon të rrjedhë në datën e marrjes së kopjes së vendimit (shih, rastin e Gjykatës, [KI144/22](#), me parashtruese *Sebahate Dervishi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 nëntorit 2022, paragrafi 52; dhe shih, rastin e GjEDNj-së, [Ëorm kundër Austrisë](#), kërkesa nr. 83/1996/702/894, Aktgjykim i 29 gushtit 1997, paragrafi 33).
38. Ky kriter është përcaktuar edhe përmes pikës (c) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton se kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
39. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit, por nuk plotëson kushtet e përcaktuar në nenin 50 të Ligjit, dhe rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes aktgjykimit të kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtrueses së kërkesës.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të nenit 49 dhe 50 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 34 (1) (c) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit..

Gjyqtarja raportuese

  
Remzie Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani